

## **Programet elektorale dhe siguria komunitare**

**Nga Xhavit Shala**

Më datën 8 Maj shqiptarët do t'i drejtohen kutive të votimit për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në qeverisjen vendore. Përgjithësisht kandidatët kanë paraqitur programet e tyre elektorale. Disa prej tyre kanë marrë pjesë në debate të ftuar në studio të ndryshme televizive. Të tjerë kanë preferuar që programet e tyre t' i shpërndajnë në fletë palosje, etj.<sup>1</sup>

Nëse do t'i shikosh programet elektorale të kandidatëve apo të ndjekësh debatet e tyre televizive do të vësh re se janë të rrallë ata të cilët, në programet e tyre elektorale kanë parashikuar diçka për çështjet e rendit e sigurisë publike dhe në përgjithësi të sigurisë në komunitet. Gjithashtu edhe drejtuesit e debateve televizive mes kandidatëve nuk kanë përfshirë pyetje të kësaj fushe për t'u drejtuar kandidatëve.

Kandidatët duket se kanë harruar apo nuk e kanë ditur fare se kanë detyrime edhe për çështjet e rendit e sigurisë publike dhe në përgjithësi të sigurisë në komunitet. Shumë prej tyre nuk janë kujtuar fare se nëse zgjidhen nesër, duhet të merren dhe me sigurinë rrugore, sigurinë ushqimore, sigurinë mjedisore, sigurinë shëndetësore apo dhe me elementë të tjerë të sigurisë njerëzore të komunitetit të cilit po i kërkojnë votën.

Shumë prej kandidatëve kanë harruar se në komunitetin që pretendojnë të menaxhojnë ka dhe përdorues droge, të sëmurë me HIV-AIDS, apo gra të dhunuara, të cilët kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe rehabilitim. Pra, në programet elektorale të kandidatëve duhet të lodhesh shumë për të gjetur ndonjë fjalë që lidhet me çështjet e rendit e sigurisë publike dhe në përgjithësi të sigurisë në komunitet.

Vetë rendi publik nënkupton tërësinë e rregullave, të sanksionuara me ligj, për të ruajtur e mbrojtur qetësinë, rregullin dhe moralin në marrëdhëniet shoqërore e qytetare. Ndërsa, siguria publike presupozon sigurinë e jetës dhe të veprimtarisë së përditshme ekonomike dhe shoqërore të qytetarit dhe të komunitetit. Shpesh përdoren të dy termat, rend dhe siguri publike.

Ruajtja e rendit dhe sigurisë publike është misioni kryesor i Policisë së Shtetit. Por, ajo nuk mund ta realizojë e vetme atë pa bashkëpunuar më qeverisjen

---

<sup>1</sup> Shkrimi është publikuar në të përditshmen "Koha Jone", datë 30.4. 2011

vendore. Kjo pasi elementë të rëndësishëm të rendit dhe sigurisë publike janë komponentë të shërbimeve që ofron qeverisja vendore.

Shpesh qytetarët i kërkojnë Policisë së Shtetit për të reaguar ndaj shumë shqetësimeve, të cilat janë detyrim ligjor i pushtetit vendor. Kjo gjendje mbingarkon policinë me detyra që nuk janë detyrim i saj si për shembull problemet e parkimeve të parregullta të makinave, zhurmat në lokale në orët e vona të mbrëmjes, etj., detyra këto të strukturave të qeverisjes vendore.

Qeverisja vendore është organi më i lartë i zgjedhur nga komuniteti në nivelin e komunës, bashkisë dhe të qarkut. Kjo qeverisje si organ ekzekutiv (kryetari komunës apo i bashkisë) është përgjegjësi kryesor për menaxhimin e jetës publike dhe cilësinë e jetës në komunitetet vendore duke përfshirë këtu edhe elementë të rëndësishëm të rendit dhe sigurisë publike në ato territore.

Sot ka një paketë ligjore e cila, ndonëse nuk është e plotë, e obligon pushtetin vendor që të merret me çështjet e rendit e sigurisë publike dhe në përgjithësi me sigurinë në komunitet.

Kështu në Ligjin Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në nenin 10 “Funksionet e veta të komunës dhe bashkisë”, në pikën IV, të titulluar “Rendi dhe mbrojtja civile”, përcaktohen si funksione të këtyre strukturave edhe ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të komunës ose bashkisë si dhe mbrojtja civile. Po në këtë ligj në nenin 11, të titulluar “Funksionet e përbashkëta”, në pikën (3-ç), përcaktohet se në funksione të përbashkëta që komuna dhe bashkia kryejnë me pushtetin qendror janë dhe ato për “rendin publik dhe mbrojtjen civile”.

Kryetarët e bashkive dhe të komunave kanë në varësi edhe policinë bashkiake, e cila kryen detyra edhe në funksion të rendit e sigurisë publike në territorin ku ajo operon. Në Ligjin Nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar me ligjin 8335 date 23.04.1998, është dhënë baza ligjore dhe kultura profesionale e bashkëpunimit të kësaj strukture me Policinë e Shtetit. Në këtë ligj, në nenin 1, përcaktohen funksionet e policisë bashkiake si organ ekzekutiv në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë apo të komunës dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të

tjera shtetërore. Ndërsa në neni 8 të po këtij ligji parashikohen detyrat e policisë bashkiake apo të komunës për sigurimin e zbatimit efektiv të urdhrave të nxjerra ne kompetencën e tyre nga kryetari i bashkisë dhe të vendimeve të këshillit në fushën e rendit e sigurisë publike e çështje të tjera. Gjithashtu ligji, në nenin 10, përcakton edhe disa funksione të policisë bashkiake në përputhje me Kodin e Procedurës Penale për marrjen e masave për shoqërimin e autorëve të veprave penale në komisariatit e policisë, për ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimit e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave deri në ardhjen e policisë gjyqësore. Po ashtu, kur çmohet e domosdoshme për ruajtjen e rendit, sipas nenit 16, shefi i komisariatit të policisë dhe kryetari i bashkisë apo komunës mund të bashkërendojnë veprimet e policive me miratim të prefektit.

Edhe Ligji Nr. 9559, datë 08.06.2006 “Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i detyron ligjërisht të zgjedhurit vendorë të bashkëpunojnë për parandalimin dhe luftën ndaj mbjelljes dhe kultivimit të bimëve narkotike, duke i bërë ata në rrethana të caktuara ligjërisht përgjegjës.

Në situata të veçanta si në rastet e emergjencave civile, siç dhe është përcaktuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile” ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e Komisioneve vendore për emergjencat civile pranë bashkisë ose komunës nën drejtimin e kryetarëve të këtyre të fundit.

Jo vetëm në ligjet e sipër cituara por edhe në Strategjinë e Decentralizimit dhe të Qeverisjes Vendore parashikohen funksione të kësaj qeverisje në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Nga ana tjetër edhe në aktet ligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit si organi që ka detyrën kryesore për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, përcaktohen detyrime për të bashkëpunuar me strukturat e pushtetit vendor në përmbushje të misionit për një komunitet më të sigurt.

Kështu në ligjin organik “Për Policinë e Shtetit” Nr. 9749, datë 4.6.2007, në nenin 122, në titullin “Policimi në komunitet” përcaktohet se drejtorët e drejtorive të policisë në qarqe hartojnë “një strategji vjetore të policimit në qark për sigurinë në komunitet”, pas këshillimeve me kryetarin e bashkisë dhe drejtues të pushtetit vendor, të cilët ushtrojnë funksionet në atë territor që

mbikëqyret nga drejtori i policisë së qarkut. Ai ua paraqet atë në përfundim drejtuesve të njësive vendore.

Edhe Strategjia e Policisë së Shtetit për vitet 2007-2013 ka në themel të saj filozofinë e policimit në komunitet. Kjo filozofi nuk mund të kuptohet pa bashkëpunimin e policisë në komunitetin dhe strukturat e pushtetit vendor, të cilat janë përfaqësuesit e këtij komuniteti. Policimi në komunitet nxit partneritetin me komunitetin, organet e qeverisjes vendore, institucionet arsimore, të shërbimit social, organizatat joqeveritare për të realizuar në mënyrë të plotë e të qëndrueshme zgjidhjen e problematikave të lidhura me parandalimin e luftën ndaj krimeve si gjakmarrja, droga (sidomos në aspektet e mbjelljes dhe kultivimit të bimëve narkotike), trafiqet, mbledhjen e municioneve, krimin në familje, sigurinë rrugore, etj., duke ndikuar kështu në rritjen e parametrave të sigurisë komunitare.

Strukturat e qeverisjes vendore mbetet institucionet më të rëndësishme me të cilat Policia e Shtetit bashkëpunon ngushtësisht për të realizuar misionin e saj të ngarkuar me ligj. Gjithashtu, bashkëpunimi i policisë në nivel vendor me strukturat e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga vetë misioni i Policisë së Shtetit si shërbim publik. Ky bashkëpunimi duhet të synojë mirëqeverisjen dhe përmirësimin të shërbimeve publike. Kjo mund të përmbledhë praktika të institucionalizuara të bashkëpunimit apo llogaridhënies, plan veprime të përbashkëta, apo strategji për përmirësimin e situatës së rendit publik sipas nevojave dy paleshe.

Baza ligjore ekzistuese për marrëdhëniet e Policisë së Shtetit me strukturat e pushtetit vendor dhe për vetë raportet e strukturave të qeverisjes vendore me çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka nevojë për përmirësime e saktësime. Megjithatë, përveç bazës ligjore ekzistuese, për marrëdhëniet mes strukturave të pushtetit vendor me Policinë e Shtetit si organi që ka ekskluzivitetin në çështjet e rendit dhe sigurisë publike, mund të aplikohet dhe nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe për çështje e sigurisë me interes dy palësh.

Si përfundim, strukturat e qeverisjes vendore duhet të ndjejnë përgjegjësinë për tu marrë me çështjet e rendit dhe sigurisë publike në territoret e tyre. Kjo përbën një detyrim ligjor. Gjithashtu është e nevojshme dhe ka akoma kohë që

çështjet e rendit dhe sigurisë publike të bëhen pjesë e programeve elektorale dhe e angazhimeve të kandidatëve për kryetar bashkie apo komune në zgjedhjet e 8 Majit.

Tirane, 28 Prill 2011